



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 89/13
Prishtinë, më 16.01.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Jelena Bontic.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Avdiu zv.ministër i Financave, Lulzim Rafuna Drejtor Ligjor në Dogana, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI, EULEX-it.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit**
4. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin nr.04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional me Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-159 për zonat ekonomike me Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**
7. **Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2012**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit

Kryetarja konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit

Kryetarja theksoi lidhur me projektligjin në fjalë janë bërë disa vërjetje në raportin e progresit dhe në komision e kemi monitoruar dhe kemi nxjerrur disa rekomandime. Disa prej qështjeve janë të përfshira e disa jo nga rekomandimet që kemi bërë. Dispozitat e projektligjit në aspektin formalo-juridik nuk janë të rregulluara si duhet dhe këto ndryshime duhet të bëhen gjatë amendamentimit, kryesisht qështje teknike. Njoftoi për një takim që ka pasur para fillimit të kësaj mbledhje me përfaqësues të OSBE-së, të cilët e tërhoqën vëmendjen rreth nenit 3 të projektligjit, përkatësisht tek trajtimi i lëndëve penale nga prokuroria speciale. Sipas OSBE-së neni 3 është në kundërshtim me kodin penal. Ne nuk mund të biem në kontraditë me kodin penal dhe për këtë qështje duhet të ketë harmonizim në mes dy ligjeve.

Ramadan Avdiu theksoi se Ministria e Financave pas analizimit të gjendjes së tanishme bazuar në dokumentet e Komisionit Evropian, pas konsultimit me gjithë mekanizmat kompetent në fushën e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë EULEX-in, Thesarin Amerikan dhe Këshillin e Evropës, kemi ardhur deri te vendimi për plotësim dhe ndryshim të ligjit për parandalim të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Në ligjin bazë, ekzistojnë disa zbrazëtira ligjore, të cilat ia vështirësojnë punën operacionale Njësisë së Intelgjencës Financiare, e të cilat vërehen tek raportimi i subjekteve të obliguara për raportim si bankat, institucionet financiare dhe kazinot, pastaj të inspektimi i NJIF-it dhe obligimi për raportim nga subjektet raportuese. Ministria e Financave pas analizimit të gjendjes dhe duke marrë për bazë që vepra penale e shpërlarjes së parave në 90% të rasteve është e lidhur me veprat e tjera, si evazioni fiskal, falsifikim dokumenteve, krijim të dokumenteve me përmbajtje të pavërteta etj., ka ardhur deri te vendimi për të zgjeruar kompetencën hetimore në rangun e të gjitha prokurorive me kompetencë lëndore dhe territoriale në Republikën e Kosovës. Më duhet të theksoj se kompetenca e Prokurorisë Speciale mbetet e rëndësishme sepse ajo mund të fillojë apo edhe të kërkojë të marrë rastin nëse mendon se duhet të hetohet nga Prokuroria Speciale. Ndërsa në qështjen e luftës kundër terrorizmit, mbeten kompetencat ekskluzive të Prokurorisë Speciale.

Lulzim Rafuna sa i përket nenit 3 është diskutuar gjatë me të gjitha palët e interesit. Si Ministri e Financave në këtë qështje kemi dashur të bëjmë reformë me qëllim të rritjes së efektivitetit të prokurorive në luftimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Qështja e kompetencave të prokurorisë është përfshirë kompetencë vendore e shteteve dhe nuk ka detyrime nga legjislacioni evropian. Për tre vite Prokuroria Speciale ka hetuar vetëm dy vepra të shpërlarjes së parave. Përmes këtyre ndryshimeve ne iu kemi lënë prokurorive në bazë të kompetencave lëndore dhe territoriale të hetojnë një rast që ka të bëjë me shpërlarjen e parave dhe jo sikurse është vepruar që të merren vetëm me në element si psh. Evazioni fiskal dhe të mbyllet qështja, por e kemi lënë të mundur që prokuroria speciale të fillojë rastin e hetimit apo edhe të marrë lëndën në shqyrtim nga prokuroritë tjera në këto qështje. Nuk vjen ndesh me kodin penal, sepse ky ligj po sjellet më vonë dhe vlejnë dispozitat e këtij ligji.

Latif Gashi mendojë që ky projektligj nuk mund të jetë në kundërshtim me kodin penal, pasi që kodi penal është bazë dhe çdo dispozitë tjetër duhet të harmonizohet me atë, sepse është kushtetutë në qështjet penale.

Salih Asllanaj sa i përket projektligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, kërkojë që të bëjmë ligje që nuk të vëne në dualizëm dhe për veprën e njëjtë të jetë kompetent vetëm një prokurori. Të precizohet dhe të dihet adresa e qartë se kush është kompetent për këtë qështje.

Hykmete Bajrami pyes Lulzimin se ku saktësisht neni 3 bie në kundërshtim me kodin e procedurës penale?

Lulzim Rafuna në kodin penal është draftuar që në një pjesë të veprave penale ceket Prokurori Special dhe kur kanë ardhur te shpërlarja e parave është cekur që veprat kundër shpërlarjes së parave do ti hetoj Prokuroria Speciale. Po edhe me ligjin bazë të cilin e kemi pasur deri tani në fuqi poashtu neni 3 ka qenë kompetencë e Prokurorisë Speciale. Kemi dashur të zgjerojmë rrethin e personave zyrtar, të cilët do të kenë fuqi ligjore për hetime në bazë të kompetencave lëndore dhe territoriale dhe dëshirojmë të kemi rezultate më të prekshme në këtë qështje.

Hykmete Bajrami në bazë të kësaj që u sqarua nuk shoh se ka kundërshtim me kodin penal sepse ne kemi vetëm zgjerim të institucioneve që do të merren me çështjen e njëjtë. Me të vërtetë kjo ndërhyrja që vjen nga ndërkombëtarët është pa pikë baze.

Kryetarja mendojë që gjatë fazës së shqyrtimit dhe amendamentimit në komision, duhet të trajtojë këtë qështje, të konsultohet kodi penal dhe të japim rekomandimet më të mira, duke mos rënë në kundërshtim edhe me ligjet tjera.

Xhevdet Neziraj theksoi se me rastin e monitorimit të ligjit, në takimin që kemi pasur në prokurorinë speciale, vërejtja e Prokurorit ka qenë se nuk ka pasur ndonjë mekanizëm ligjor në sekuestrimin e pasurisë kur e ka hetuar origjinën sesi ka ardhur deri te paraja, prandaj është me rëndësi rregullimi i asaj qështje në këtë projektligj siç është kërkuar.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin nr.04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Hasime Krasniqi grupi punues e ka kryer punën e tij, duke marrë parasysh të gjitha kërkesat dhe propozimet e anëtarëve të grupit punues që kanë qenë prezent. Një kërkesë që ka ardhur me vonesë nga Ballkan Suhareka e cila nuk është paraqitur me kohë para grupit punues dhe në bashkëbisedim me

ministrinë përkatëse kemi vlerësuar se ajo kërkesë është dashur të shqyrtohet në ministrinë sponzorizuese dhe pastaj në komision. Si grup punues paraqesim amendamentet para komisionit për miratim.

Sevdije Lama theksoi se ka dërguar një kërkesë me vonesë prej Ministrinë së Tregtisë dhe Industrisë që në fakt është kërkesë prej bizneseve dhe nuk është trajtuar, dhe kam një propozim që të shtyhet kjo qështje dhe të trajtohet në grup punues bashkë me Ministrinë e Financave.

Kryetarja një sqarim, Qeveria brenda afatit dhejtë ditë mund të bëjë ndonjë amendament, mirëpo në rast se materiali vë prej Ministrisë nuk ka nevojë që të dorëzohet nga deputetët. Më pas citoi nenin e rregullores ku parashihet që komisioni të ftoj Ministrinë sponzorizuese që të marr pjesë në mbledhjet e komisionit me rastin e shqyrtimit të projektligjeve dhe të drejtën që Ministria të bëjë propozimin. Por komisioni nuk është i obliguar të trajtojë kërkesat që vijnë nga ministrinë e tjera, aq më pak në formën të cilën ka ardhur prej Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Latif Gashi diqka nuk është e qartë, thuhet se ka pasur kërkesa nga bizneset kurse në anën tjetër thuhet se qeveria ka rekomanduar një ndryshim të këtij Projektligji, është mirë të jemi në dijeni nëse grupi punues ka pranuar kërkesa jashtë asaj qfarë ka propozuar qeveria me projektligj?

Xhevdet Neziraj sqaroi se kërkesa është bërë nga Drejtori i Ballkan-it dhe i kam sugjeruar të drejtohet në komision, nuk e di se a është shqyrtuar nga grupi punues, pasi që në Komision ka ardhur me vonesë por nëse është diqka e mirë për vendin, nëse është leverdi ekonomike pse mos të shqyrtohet.

Sali Asllanaj nuk mendojë që është komisioni është zyrë për parashitja dhe propozime dhe të merret me të gjitha shkresat. Ne kemi punuar në projektligj dhe detyra e jona do të ishte të merremi me amendamentet që vijn sipas procedurës së rregullt dhe në asnjë formë me kërkesa individuale të bizneseve. Jemi konsultuar me Ministrinë e Financave dhe na kanë garantuar se një pjesë e produkteve të Kompanisë Ballkan Suhareka janë përfshirë në lirimet doganor në këtë projektligj.

Më pas Komisioni votoi dhe miratoi njëzëri të gjitha amendamentet e propozuara nga grupi punues.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve nxorri këtë

REKOMANDIM

Miratohen amendamentet e grupit punues për Projektligjin nr.04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor. Raporti i Komisionit procedohet për shqyrtim dhe miratim për procedurat e mëtutjeshme të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional me Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja konstatoi se nga analiza që i është bërë projektligjit dhe deklaratës së Departamentit të buxhetit në Ministrinë e Financave si dhe amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL shihet se nuk ka implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

Projektligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-159 për zonat ekonomike me Raportin me amendamente të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja konstatoi se nga analiza që i është bërë Projektligjit dhe deklaratës së Departamentit të buxhetit në Ministrinë e Financave si dhe amendamenteve të Komisionit Funksional shihet se nuk ka implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri e nxorri këtë

REKOMANDIM

Projektligji për zonat ekonomike dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2012

Komisioni njëzëri e nxorri këtë

REKOMANDIM

Miratohet raporti vjetor i punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2012.

8. Të ndryshme

8.1. Kryetarja njoftoi për projektligjet të cilat janë në procedurë në shqyrtimit në komision si komision funksional dhe nevojën për intensifikimin e punëve përfundimin e tyre.

8.2. Kryetarja njoftoi se grupi punues për monitorimin e ligjit do të vazhdoj punën në realizimin e vizitave sipas planit të veprimit për mbikëqyrjen e zbatimi të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe brenda këtij muaji të përfundojë punën.

8.3. Kryetarja, po ashtu njoftoi anëtarët e komisionit, se Kryesia në mbledhjen e mbajtur këtë javë ka nxjerrur një përfundim dhe ka kërkuar nga komisionet parlamentare që të dërgojnë planet vjetor të punës deri më datën 28 janar 2013, ku më pas do të hartohet plani i Kuvendit. Për këtë qështje kam kërkuar nga koordinatori i komisionit që të konsultohet me administratën që nëse është e mundur që plani të dorëzohet më 29 janar 2013, pasi që në këtë datë është planifikuar të mbahet një takim i përbashkët në mes të Komisionit dhe GIZ- së për diskutimin e planeve të përbashkëta të këtij viti.

8.4. Kryetarja bëri vërejtje për stafin e komisionit për shkak të pakujdesisë në përgatitjen e rendit të ditës dhe shpërndarjes së materialeve, ku mungonte material i kompletuar raportit të punës së komisionit për vitin dhe kërkoi që kjo gjë mos të përsëritet më.

Mbledhja përfundoi: 12:15.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona

